



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK  
BASHKIA DURRËS

RELACION

**PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA KUNDËRSHPËRBLIM, QENDRËS PËR ZHVILLIM KOMUNITAR “SOT PËR TË ARDHMEN”, TË DY AMBJENTEVE: S1 = 79.1M<sup>2</sup> DHE S2 = 90.4 M<sup>2</sup>, TË NDODHURA NË KATIN E PARË TË BANESAVE SOCIALE, ME NR. PAS. 5/270, ZK 8513, LAGJIA NR. 17, RRUGA “DALIP PEZA”, PRONË E BASHKISË DURRËS, PËR NJË AFAT KOHOR 3 VJET, PËR T’U PËRDORUR: “PËR SHËRBIME DHE MBËSHTETJE SOCIALE E KUNDËR DHUNËS NË FAMILJE DHE ME BAZË GJINORE; PËR NISMA NË MBËSHTETJE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE, ARSIMIT, EDUKIMIT, PUNËSIMIT E ZHVILLIMIT EKONOMIK DHE PËR INFORMIMIN, NDËRGJEGJËSIMIN, INTEGRIMIN, BASHKËJETESËN KOMUNITARE DHE DIALOGUN SOCIAL”**

**PARA KËSHILLIT BASHKIAK**

**K Ë T U**

Projektvendimi që po ju paraqesim për miratim, ka për qëllim dhënie në përdorim, pa kundërshpërblim, Qendrës për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”, të dy ambjenteve: S1= 79.1m<sup>2</sup> dhe S2 = 90.4 m<sup>2</sup>, të ndodhura në katin e parë të banesave sociale, me nr. pas. 5/270, ZK 8513, lagjia nr. 17, rruga “Dalip Peza”, pronë e Bashkisë Durrës, për një afat kohor 3 vjet, për t’u përdorur “Për shërbime dhe mbështetje sociale e kundër dhunës në familje dhe me bazë gjinore; për nisma në mbështetje të shërbimeve publike, arsimit, edukimit, punësimit e zhvillimit ekonomik dhe për informimin, ndërgjegjësimin, integrimin, bashkëjetesën komunitare dhe dialogun social”.

Referuar kërkesës së ardhur nga Qendra komunitare si dhe akteve bashkëlidhur kërkesës, rezulton se: Qendra për zhvillim komunitar është një organizatë e pavarur, jofitimprurëse dhe joqeveritare, e regjistruar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim nr. 830, datë 02.10.2013, e pajisur me NIPT L32221751H, me nr. Liçence për shërbime komunitare LN-7513-02-2014 dhe nr. liçence për kurset e formimit profesional LN-7650-03-2014.

Qëllimi i krijimit të Qendrës është arritja e kohëzisionit social, ekonomik, politik e kulturor duke priorizuar barazinë gjinore nëpërmjet aplikimit të qëndrimeve dhe sjelljeve të reja liberale dhe demokratike; ndërjetësimin që promovon, bashkëjetesën dhe bashkëpunimin ndërmjet komuniteteve të ndryshme gjinore, moshave, etnike, kulturore fetare dhe forcimin në këto komunitete të vlerave të

diversitetit, tolerancës, demokracisë dhe bashkëjetesës, unitetit social e barazisë gjinore, duke punuar për zbatimin e këtyre principeve nëpërmjet lobimit, advokacisë e dhënies së praktikave më të mira të shërbimeve për komunitetet multnietnike, multikulturore, grave, të rinjve, fëmijët dhe moshën e tretë në nevojë.

Vizioni i Qendrës sot për një të ardhme më të mirë, ka këto drejtime strategjike:

Barazia gjinore dhe shërbimet ndaj viktimave të dhunës; formimi profesional dhe ndërmjetësim për punësim dhe shërbimet komunitare; kujdesi dhe shërbimet mjedisore; mirëqeverisja dhe bashkëpunimi institucional, promovimi i vendit nëpërmjet artit, traditës dhe kulturës.

Qendra është e regjistruar pranë institucioneve të tatim taksave me nr. identifikimi (NIPT) L3222175H. Nga informacioni i marrë nëpërmjet sistemit elektronik të Drejtorisë Rajonale Tatimore Durrës, del se aktualisht Qendra për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen” ka status Aktiv dhe nuk ka detyrime tatimore të papaguara.

Gjithashtu nga deklarata mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme i vënë në dispozicion nga ana e përfaqësuesit ligjor, del se Qendra për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”, dhe drejtuesi ekzekutiv i saj, nuk janë në ndjekje penale, apo të kenë proces gjyqësor lidhur me qëllimin për të cilën është krijuar Qendra.

Duke pasur për bazë qëllimin për të cilën është krijuar kjo qendër, si zhvillimin e komuniteteve; përmirësimin e statusit të grave, të fëmijëve e të rinjve; përmirësimin e dialogut social mes komuniteteve dhe qeverisjes lokale dhe qendrore etj., si dhe faktit tjetër se Qendra vepron sipas të gjitha rregullave dhe ligjeve të shtetit, është i regjistruar tek tatim taksat, është me status aktiv, nuk ka detyrime ndaj tatim taksave dhe personave të tjerë fizikë dhe juridikë, mendojmë se duhet t’i plotësohet kërkesa për dhënien në përdorim, pa kundërshtim të dy ambjenteve, aktualisht të lira, që ndodhen në katin e parë të ndërtesës me emërtimin banesa sociale, pronë e Bashkisë.

Mendojmë se koha e dhënies në përdorim të jetë 3 vjet.

Sqarojmë se referuar ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, është tagër i këtij Këshilli për të miratuar këtë propozim. Neni 54 i ligjit përcakton se “... Këshilli bashkiak ka kompetenca të miratojë tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve...”.

### **Bashkëlidhur dokumentacionin:**

- Kërkesa, ardhur nga Qendra për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”, drejtuar institucionit të Bashkisë Durrës, e administruar me nr. 2189, datë 13.02.2020, me anë të së cilës kërkon dhënien në përdorim, pa kundërshtim, të ambjenteve në pronësi të bashkisë.
- Vendimi nr. 830, datë 02.10.2013, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrim të Qendrës për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”, si organizatë e pavarur, jofitimprurëse dhe joqeveritare.
- Statusi dhe Akti i themelimit i Qendrës për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”, i noterizuar.
- Vertetim gjeneruar nga sistemi elektronik, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës, datë 18.02.2020, ku rezulton se Qendrës për zhvillim komunitar “Sot për të Ardhmen”, nuk ka detyrime të papaguara.
- Çerti

fikatë regjistrimi me numër identifikimi L32221751H, gjeneruar nga Drejtoria e përgjithshme e tatimeve dhe mban datën 21.10.2013.

- Liçencë lëshuar nga Ministria e linjës me nr. LN-7513-02-2014, datë lëshimi 20.02.2014, dhënë për veprimtarinë për shërbime të perkujdesit komunitar, pa afat.
- Liçencë lëshuar nga Ministria e linjës me nr. LN-7650-03-2014, datë lëshimi 18.03.2014, fusha e veprimtarisë për kurse të formimit profesional, pa afat.
- Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme.
- Genplani i pronës që kërkohet të jepet në përdorim, pa kundërshtim.